

VENDIM
Nr.517, datë 13.5.2009

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET PËR NË KUVENDIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË 28.6.2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, që do të zhvillohen më 28.6.2009.

2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për nënshkrimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij memorandum.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
QË DO TË ZHVILLOHEN NË DATË 28.6.2009

Mbështetur në dekretin nr.5598, datë 30.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, më 28.6.2009 do të zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;

Mbështetur në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ngarkohet me detyrën për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

Mbështetur në faktin që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është seriozisht i angazhuar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, demokratike, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë këto zgjedhje për të ardhmen e vendit dhe në kuadër të marrëveshjes së stabilizim-asocimit me Bashkimin Europian;

Të bindur se për realizimin e këtyre standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë; me qëllim përmbushjen në shkallë institucionale të këtij bashkëpunimi;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Këshilli i Ministrave) dhe

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ-ja) nëshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi.

Palët në këtë memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi dhe bien dakord si më poshtë:

I. Detyrimet e Këshillit të Ministrave

Këshilli i Ministrave mbështetet dhe i garanton KQZ-së:

1. Sigurimin e ambienteve të nevojshme për KQZ-të dhe VNV-të, duke përfshirë kushte të përshtashme për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, si dhe për sigurimin e linjave të komunikimit.

2. Sigurimin e ambienteve për zyrat rajonale zgjedhore të KQZ-së.
3. Angazhimin e strukturave në varësi të Këshillit të Ministrave për transportin e bazës materiale zgjedhore, nga KQZ-ja në KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas.

4. Ministria e Brendshme ngarkohet të mbikëqyrë përmbushjen e angazhimeve të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë memorandum, nga të gjitha institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave dhe organet e qeverisjes vendore.

5. Prefektët, mbështetur në Kodin Zgjedhor dhe në aktet e KQZ-së, bashkërendojnë realizimin e detyrave të parashikuara në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe në këtë memorandum në të gjithë territorin e juridiksionit administrativ përkatës.

II. Detyrimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

KQZ merr përsipër dhe garanton:

1. T'i sigurojë Këshillit të Ministrave dhe të gjitha institucioneve në varësi të tij, në kohën e nevojshme, informacionin e duhur për të lejuar përmbushjen e angazhimeve, në funksion të administrimit të procesit zgjedhor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njeh ligji. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve realizohet në përputhje me ligjin dhe në mirëkuptim ndërmjet palëve. Në këtë kuadër, palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e përgatitjes së zgjedhjeve.

IV. Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 19 maj 2009

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE
Arben Ristani